

Rezultatet e IDEA-s

1. 10 njësi të reja ose të përmirësuara në mbështetje të studentëve me nevoja të veçanta (SNV) në universitetet pjesëmarrëse (AL, MN, KS)
2. 10 rregullore për njësitë e aksesueshmërisë në universitetet pjesëmarrëse (AL, MN, KS)
3. 3 dokumenta të ndërhyrjeve normative sugjeruar Ministrive të Arsimit të Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi.
4. Krijimi i infrastrukturës për SNV dhe pajisja me teknologji ndihmëse efektive dhe relevante në 10 universitetet pjesëmarrëse (AL, MN, KS)
5. Pritja e kapaciteteve të stafit pedagogjik, menaxherial dhe administrativ të universiteteve partnere që merren dhe zbatojnë praktika të arsimit gjithëpërfshirës.
6. Tekste shkollore të aksesueshme për SAK (dokumente të aksesueshme të llojit .docx, .pdf, libër dixhital që flet (Daisy-3), libra shkollorë në format Audio-MP3, libra shkollorë me alfabet Braj, dhe Libra shkollorë të mëdhenj të gatshëm për printim).
7. Nxitja e bashkëpunimit në marrëdhëniet e jashtme për të përmirësuar aksesin në Arsimin e Lartë dhe punësimin e studentëve me nevoja të veçanta.
8. Pritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe studentëve mbi të kuptuarit e rëndësisë së arsimit gjithëpërfshirës në arsimin e lartë – me mbështetjen e organizatave të dedikuara për personat me nevoja të veçanta.

PARTNERËT

INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË

Universiteti Polis (AL)- Coordinator
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (AL)
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (AL)
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër (AL)
Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" (AL)
Universiteti Epoka (AL)
Universiteti i Prishtinës (KS)
Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit – Mitrovicë (KS)
Kolegji Universum (KS)
Universiteti i Donja Goricës (MNE)
Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës (GR)
Universiteti Masaryk (CZ)
Universiteti i Limerikut (IE)

ORGANIZATA/ NGO

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF, AL)
Shoqata e Fëmijëve Paraplegjikë dhe të Paralizuar (HANDYKOS, KS)
Shoqata e të Rinjve me Aftësi të Kufizuara në Mal të Zi (AYDM, MNE)

Kontakt:
Flora Krasniqi (Project Coordinator)
e-mail: flora_krasniqi@universitetipolis.edu.al
web: www.idea-cbhe.com



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union



IDEA

Inclusive tertiary EDUCATION in the West BalkanS

618859-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP



OBJEKTIVI I PROJEKTIT IDEA

Projekti IDEA synon të adresojë një prej sfidave kryesore me të cilat Europa dhe rajoni i Ballkanit, në veçanti, do të përballen deri në fund të viteve 2020, si dhe të mbështesë axhendën e politikave europiane për barazi dhe përfshirje sociale në arsimin e lartë.

Institucionet e arsimit të lartë në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk kanë një kuadër politik, njohuri, infrastrukturë, pajisje, teknologji, si dhe edukim e trajnim për të lehtësuar arsimin gjithëpërfshirës dhe barazinë e qasjes në arsimin e lartë për studentët me nevoja të veçanta dhe ata me vështirësi në të mësuar.

Në këtë këndvështrim, qëllimi i përgjithshëm i projektit IDEA është të përmirësojë aksesin, të krijojë kushte të të mësuarit të arsimit gjithëpërfshirës dhe të krijojë mundësi punësimi për studentët me nevoja të veçanta dhe ata me vështirësi në të nxënë.

PAKETA E PUNËS 1 – PËRGATITJE

D 1.2 – Master-Plan për të adresuar nevojat dhe dëshirat e arsimit të lartë të aksesueshëm në Ballkanin Perëndimor

PAKETA E PUNËS 2 – ZHVILLIMI

WP 2.1 Krijimi ose Përmirësimi i Njësive të Aksesueshmërisë
D2.1.1 – Zhvillimi i protokolleve të reja dhe hartimi i dokumentit të politikave me sugjerime normative (për Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi) bazuar në Vizitat Studimore për të nxjerrë modele të praktikave më të mira
D 2.1.2 – Pajisje, ngritja dhe krijimi i Njësive të Aksesueshmërisë
WP 2.2. Trajnim për Shërbimet e aksesueshmërisë
D 2.2.1 – Trajnim i Shërbimeve të Administrimit të Universitetit për arsim të lartë të aksesueshëm
D 2.2.2. – Trajnim i stafit akademik mbi metodat e mësimdhënies, të mësuarit dhe të vlerësimit të arsimit të lartë përfshirës
D 2.2.3. – Pilotimi dhe Hartëzimi i proceseve për krijimin e Njësive të Aksesueshmërisë



PAKETA E PUNËS 3 – SIGURIMI I CILËSISË

D 3.1 – Plan Veprimi për Monitorimin e Cilësisë
D 3.2 – Auditimi i jashtëm
D 3.3 – Raporti Afatmesëm për Monitorimin e Cilësisë dhe Rekomandime
D 3.4 – Raporti Përfundimtar i Monitorimit të Cilësisë

PAKETA E PUNËS 4 – SHPËRNDARJA & SHFRYTËZIMI

D 4.1 – Strategjia e Shpërndarjes së informacionit (DS)
D 4.2 – Zhvillimi dhe Koordinimi i produkteve të informimit, faqja e internetit të projektit dhe të njësive të aksesueshmërisë dhe zhvillimi/përshtatja e aplikacioneve
Organizimi i Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara për ndërgjegjësim, si dhe konferenca përmbyllëse e Projektit
D 4.3 – Shpërndarja dhe Shfrytëzimi

PAKETA E PUNËS 5 – MENAXHIMI

5.1. Menaxhimi i vazhdueshëm i projektit
5.2. Raporti Afatmesëm i Menaxhimit të Projektit
5.3. Vlerësimi dhe Auditimi i Jashtëm
5.4. Raporti Përfundimtar i Menaxhimit të Projektit

GRUPET E SYNUARA

- 1) Njësiti e Shërbimit Studentor të IAL-ve bashkëpunuese të vendeve partnere
- 2) Studentët me nevoja të veçanta
- 3) Studentët që përballen me vështirësi në të nxënë

Nevojat e veçanta të grupeve të synuara që do të adresohen nga njësiti e Shërbimit të Studentëve në IAL-të pjesëmarrëse të Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi, do të jenë:

1. Qasje në komunikim ndërpersonal me administratën e universitetit dhe/ose anëtarët e stafit akademik
2. Qasje në ambientet e kampusit, si:
 - a. Biblioteka
 - b. Auditorë & klasa
 - c. Laboratorë
 - d. Shkallë
 - e. Ashensorë
 - f. Tualet
 - g. Sekretari dhe zyra e regjistrimit
 - h. Restorante / Ëmbëltoje Universitare
 - i. Orientimi në të gjithë kampusin
3. Qasje në materialet mësimore
4. Qasje në dërrasat e bardha të klasës dhe projektimet e klasës
5. Qasje në shënime, artikuj dhe në pjesëmarrjen në provime
6. Qasje në informacion, përmbajtje të internetit dhe aplikacioneve TIK
7. Mbështetje e këshillimit profesional psikologjik. (SVN).

